



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 176 Rep.

Nr. 72 Kol.

Tarifa e pullës u llikujdua

REVOKIM

(Për Kontratën e Shitjes së Aksioneve të Zotëruara në Shoqëri

me Nr. Rep.1132 dhe Nr. Kol.551, datë 10.12.2016)

Në Tiranë sot, më datë 14 Shkurt 2018 (Dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres **MARIANA DAKA**, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë noteriale Rruga "Emin Duraku", Pallati 3/1, me NIPT L42125011B, u paraqitën personalisht, palët e poshtëshënuara, të cilët me vullnetin e tyre të lirë, ranë dakord të nënshkruajnë këtë Revokim Kontrate :

SHITËSET: **Ridvana DULAKU**, e bija e Saitit dhe e Lumturisë, e datëlindjes 05 Janar 1968, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028000995, dhe numër personal G85105115Q, e cila zoteron 34%(tridhjetë e katër përqind) të pjesëve ose 34.000(tridhjetë e katër mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (*që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSE*)

Holta DULAKU, e bija e Viktorit dhe e Shpresës, e datëlindjes 16 Prill 1974, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028592340,dhe numër personal H45416057U, e cila zoteron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33.000 (tridhjetë e tre mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (*që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSI*).

Melina DULAKU, e bija e Bestarit dhe e Valentinës, e datëlindjes 01 Qershori 1973, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028471477, dhe numër personal H35601216T, e cila zoteron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33.000 (tridhjetë e tre mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (*që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSI*)

BLERËSI: **Sotiraq TOSHI**, i biri i Mihallaqit dhe Donikës, e datëlindjes 17 Shtator 1969, lindur në Korcë, shtetas shqiptar, banuese në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr.027826446 dhe me numër personal G90917030K, (*që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet BLERËSI*)

Secili prej personave të mësipërm në vijim do të quhet "Pala" dhe bashkërisht "Palët".

MEQENËSE

Palët kanë lidhur më datë 10.12.2016 përpara zyrës noteriale të Noteres Mariana Daka, një Kontratë Shitje e Aksioneve të Zotëruara në Shoqëri me Nr.Rep.1132 dhe Nr.Kol.551, me

objekt kontrate "shitjen me rezervë të aksioneve" të shoqërisë "Tring TV"Sh.a. (në vijim quajtur Kontrata);

- Blerësi, Z.Sotiraq Toshi, do të blinte 80% të aksioneve të shoqërisë "Tring TV"Sh.a. ose 80'000 aksione, kundrejt çmimit total 200.000.000 (dyqind milion) Lekë.
- Përkatësisht Z.Sotiraq Toshi nga Znj. Ridvana Dulaku, do të blinte me rezervë 26.000 (njëzetë e gjashtë mijë) aksione ose 26% të aksioneve që zotëronte ajo në shoqëri; nga Znj. Holta Dulaku, do të blinte me rezervë 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% të aksioneve që zotëron në shoqëri; nga Znj. Melina Dulaku, do të blinte me rezervë 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% të aksioneve që zotëron në shoqëri.
- Deri më datën e nënshkrimit të këtij Akti Notarial, Z.Sotiraq Toshi, nuk e ka kryer likujdimin e çmimit total prej 200.000.000 (dyqind milion) Lekë, për rrjedhojë Palët kanë rënë dakord që të zgjidhin me marrëveshje Kontratën, në përputhje me dispozitat e nenit 868 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Aksioneret e shoqërisë "Tring Tv"sh.a., Zj.Ridvana Dulaku, Zj.Holta Dulaku dhe Zj.Melina Dulaku, e miratojnë këtë revokim kontrate, nëpërmjet Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë, datë 14.02.2018.

Si rrjedhojë, nga sa më siper, Shitësi dhe Blerësi bien dakord si në vijim:

1. Ky Revokim i Kontratës së Shitblerjes me Nr.Rep.1132 dhe me Nr.Kol.551, datë 10.12.2016 nga Notere Mariana Daka, hyn në fuqi duke filluar nga data e nënshkrimit të saj.
2. Palët deklarojnë dhe pranojnë se me nënshkrimin e këtij Revokimi të Kontratës së Shitblerjes me Nr.Rep.1132 dhe me Nr.Kol.551, datë 10.12.2016, të noteres Mariana Daka, palët do të kthehen në gjendjen përpara nënshkrimit të Kontratës së Shitjes së Aksioneve të zotëruara në Shoqërinë "TRING TV" Sh.a..
3. Pas këtij revokimi dhe nënshkrimit të tij nga palët, raportet e pronësisë në kapitalin e Shoqërisë "Tring Tv" Sha për aksionerët e saj do të jetë:
 - Znj. Ridvana Dulaku, do të zotërojë 34 % (tetë përqind) të aksioneve.
 - Znj. Holta Dulaku, do të zotërojë 33 % (gjashtë përqind) të aksioneve.
 - Znj. Melina Dulaku, do të zotërojë 33 % (gjashtë përqind) të aksioneve.

Pra kapitali i shoqërisë do të rezultojë i ndarë si më poshtë:

| Aksioneret | % | Aksione | Kapitali |
|----------------|------------|----------------|--------------------|
| Ridvana Dulaku | 34 | 85,000 | 85,000,000 |
| Holta Dulaku | 33 | 82,500 | 82,500,000 |
| Melina Dulaku | 33 | 82,500 | 82,500,000 |
| TOTAL | 100 | 100,000 | 250,000,000 |









4. Palët do të ruajnë konfidencialitetin në lidhje me përbajtjen e Kontratës së Shitblerjes me Nr.Rep.1132 dhe me Nr.Kol.551, datë 10.12.2016 nga Notere Mariana Daka dhe të këtij Revokimi si dhe në lidhje me të gjitha të dhënat me karakter konfidencial për të cilat Palët kanë marrë dijeni në lidhje me aktivitetin e palës tjetër gjatë zbatimit të Kontratës së Shitjes.



6. Ky Revokim përbën të gjithë mirëkuptimin ndërmjet Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje ose mirëkuptim të mëparshëm, me shkrim ose me gojë, midis subjekteve që janë palë në këtë Marrëveshje. Kjo marrëveshje nuk mund të amendohet, ndryshohet ose modifikohet, me përjashtim të një dokumenti të ri nga palët pjesëmarrëse.

7. Ky Revokim u hartua nga unë Noterja, dhe pasi iu lexua me zë të lartë dhe të qartë palëve, teksti i këtij Revokimi u gjet sipas Ligjit dhe vullnetit të palëve. Palët më deklaruan se e kuptuan përbajtjen e revokimit në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, duke e nënshkruar atë rregullisht përpara meje, ndërsa unë Noterja i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas legjisacionit të Republikës së Shqipërisë.

PALËT

SHITËSET
Ridvana DULAKU

Holta DULAKU

Melina DULAKU

BLERËSI
Sotiraq TOSHI

NOTERE
Mariana DAKA



Mariana Daka.
C.P.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Shoqëria "Tring TV" Sh.a

VENDIM

I

ASAMBLESË SË AKSIONERËVE TË SHOQËRISË
"Tring TV" Sh.a

Sot, me datë 14.02.2018 (dymijë e tetëembëdhjetë), në orën 11:00, në selinë e Shoqërisë me Ofertë Private "Tring TV" Sh.a, të ndodhur në adresën: Rruga "Fabrika e Qelqit", Zona Kadastrale 8230, me Nr.Pas 2/63 Tiranë, Shqipëri, për rrethana të parashikuara zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të kësaj Shoqërie.

Shoqëria "Tring TV" Sh.a, person juridik shqiptar, i regjistruar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Nr. 32519, datë 20.12.2004, me seli në rrugën "Fabrika e Qelqit", Zona Kadastrale 8230, me Nr.Pas 2/63 Tiranë, Shqipëri, me numër Identifikimi (NIPT) K61931005K dhe kapital themeltar të shoqërisë, në vlerën 250'000'000 (dyqind e pesëdhjetë milion) lekë i ndarë në 100'000 (njëqind mijë) aksione të zakonshme, të barazvlerëshme me vlerën nominale 10'000 (dhjetë mijë) lekë për aksion dhe aksionare të Shoqërisë, Z. Sotiraq Toshi, që zotëron 80% (tetëdhjetë përqind) të pjesëve ose 200'000 (dyqind mijë) aksione nominative, Znj. Ridvana Dulaku, që zotëron 8% (tetë përqind) të pjesëve ose 20'000 (njëzetë mijë) aksione nominative, Znj. Holta Dulaku, që zotëron 6% (gjashtë përqind) të pjesëve ose 15'000 (pesëmbëdhjetëmijë) aksione nominative dhe Znj. Melina Dulaku që zotëron 6% (gjashtë përqind) të pjesëve ose 15'000 (pesëmbëdhjetëmijë) aksione nominative, të treja së bashku përbëjnë 100% (njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Tring TV" Sh.a.

Z
K

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë "Tring TV" Sh.a, është thirrur me kërkesën e aksionarëve të shoqërisë dhe njëkohësisht nga ana e Znj. Ridvana Dulaku, në cilësinë e Kryetares së Këshillit të Administratorëve.


Aksionaret pjesëmarrës, në mënyrë unanime vendosin që kjo mbledhje asambleje të drejtohet nga Znj. Ridvana Dulaku, në cilësinë e drejtueses së kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme.

Drejtuesja e mbledhjes, Znj. Ridvana Dulaku, merr përsipër drejtimin e kësaj mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë. Ajo verifikon pjesëmarrjen e aksionarëve të shoqërisë, nga ku rezulton që marrin pjesë dhe janë të pranishëm, si më poshtë:

Sotiraq TOSHI, i biri i Mihallaqit dhe Donikës, i datëlindjes 17 Shtator 1969, lindur ne Korçë, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit Nr. 027826446, dhe numër

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
Shoqëria "TRING TV" Sh.a

personal G90917030, i cili zotëron 80% (tetëdhjetë përqind) të pjesëve ose 200.000 (dyqind mijë) aksione nominative, të kapitalit thmeletar të shoqërisë.



Ridvana DULAKU, e bija e Saitit dhe e Lumturisë, e datëlindjes 05 Janar 1968, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028000995, dhe numër personal G85105115Q, e cila zotëron 8% (tetë përqind) të pjesëve ose 20'000 (njëzetë mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Holta DULAKU, e bija e Viktorit dhe e Shpresës, e datëlindjes 16 Prill 1974, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028592340, dhe numër personal H45416057U, e cila zotëron 6% (gjashtë përqind) të pjesëve ose 15'000 (pesëmbëdhjetëmijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Melina DULAKU, e bija e Bestarit dhe e Valentinës, e datëlindjes 01 Qershor 1973, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028471477, dhe numër personal H35601216T, 6% (gjashtë përqind) të pjesëve ose 15'000 (pesëmbëdhjetëmijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Pas verifikimit të kuoromit për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, rezulton se janë të pranishëm të gjithë Aksionerët e Shoqërisë të cilët zotërojnë 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit ose 100.000(njëqindmijë) aksione nominative të kapitalit të Shoqërisë "Tring TV" Sh.a

Drejtuesja e mbledhjes Znj. **Ridvana Dulaku**, pasi konstaton se Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve është mbledhur rregullisht dhe në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", përkatësisht nenin 135/2 shkronja b dhe j, nenin 138/4, e vijues të tij, dhe Statutit të shoqërisë, e deklaron të mbledhur rregullisht dhe në gjendje për të vendosur mbi,

Rendin e ditës si më poshtë:

- Miratimi e revokimit të kontratës së shitjes së kuotave Nr.1132 Rep dhe Nr. 551 Kol shitjes i aksioneve të shoqërisë
- Të tjera dhe eventuale.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Shoqërisë "Tring TV" Sh.a, pasi shqyrtoi cështjen mbi rendin e ditës dhe dokumentacionin përkatës, në përfundim, me unanimitet të plotë,

VENDOSI

Të miratojë revokimin e shitjes së aksioneve të shoqërisë tek blerësi Z.Sotiraq Toshi
Pas revokimit dhe nënshkrimit të saj nga të gjithë aksionerët,, raportet e pronësisë në kapitalin e Shoqërisë "Tring Tv" Sha për aksionerët e saj do të jenë:

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
Shoqëria "TRING TV" Sh.a

- Y.S.*
1. Znj. Ridvana Dulaku, do të zotërojë 34 % (tetë përqind) të aksioneve.
 2. Znj. Holta Dulaku, do të zotërojë 33 % (gjashtë përqind) të aksioneve.
 3. Znj. Melina Dulaku, do të zotërojë 33 % (gjashtë përqind) të aksioneve.

Pra kapitali i shoqërisë do të rezultojë i ndarë si më poshtë:

| Aksioneret | % | Aksione | Kapitali |
|----------------|------------|----------------|--------------------|
| Ridvana Dulaku | 34 | 85,000 | 85,000,000 |
| Holta Dulaku | 33 | 82,500 | 82,500,000 |
| Melina Dulaku | 33 | 82,500 | 82,500,000 |
| TOTAL | 100 | 100,000 | 250,000,000 |

Shoqëria nuk bën ndryshime të tjera, të cilat mbeten ashtu sic janë të parashikuara në Statut.

Sa më sipër, ky vendim do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për të pasqyruar ndryshimet përkatëse, në perputhje me nenin 12, 158, 167 e vijues, të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe nenit 43 e vijues, të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shoqëria "Tring TV" Sh.a
Aksionerët e Shoqërisë

RIDVANA DULAKU

HOLTA DULAKU

MELINA DULAKU



VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
Shoqëria "TRING TV" Sh.a

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA E NOTËRISË TIRANË

Nr. 1132 Rep.

Nr. 551 Kol.

Tarifa e pulles u shkujdus



**KONTRATË SHITJE
E AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NË SHOQËRI**

Sot, më datë 10 Dhjetor 2016, para meje noteres MARIANA DAKA, Anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë notoriale Rruga "Emin Duraku", Pallati 3/1, me NIPT L42125011B, u paraqitën shtetasit si më poshtë:

SHITËSET: Ridvana DULAKU, e bija e Saitit dhe e Lumturisë, e datëlindjes 05 Janar 1968, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028000995, dhe numër personal G85105115Q, e cila zoteron 34% (tridhjetë e katër përqind) të pjesëve ose 34.000 (tridhjetë e katër mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSE)

Holta DULAKU, e bija e Viktorit dhe e Shpresës, e datëlindjes 16 Prill 1974, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028592340, dhe numër personal II45416057U, e cila zoteron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33.000 (tridhjetë e tre mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSD).

Melina DULAKU, e bija e Bestarit dhe e Valentinës, e datëlindjes 01 Qershor 1973, lindur në Tiranë, shtetase shqiptare, banuese në Tiranë, mbajtëse e Kartës së Identitetit Nr 028471477, dhe numër personal H35601216T, e cila zoteron 33% (tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33.000 (tridhjetë e tre mijë) aksione nominative, të kapitalit themeltar të Shoqërisë, (që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet SHITËSI)

BLERËSI: Sotiraq TOSHI, e biri i Mihallaqit dhe Donikës, e datëlindjes 17 Shtator 1969, lindur në Korçë, shtetas shqiptar, banuese në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit Nr 027826446, dhe numër personal G90917030K, (që këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet BLERËSI)

KUSHTE PARAPRAKE

Shoqëria "Tring TV" Sh.a, person juridik shqiptar, i regjistruar me vendim të Gjykatës së Kryesit Gjyqësor, Tiranë, me Nr. 32519, datë 20.12.2004, me seli në rrugën "Fabrika e Qelqit", Zona Kadastrale 8230, me Nr.Pas 2/63 Tiranë, Shqipëri, me numër Identifikimi (NIPT) K619334005K dhe kapital themeltar të shoqërisë, në vlerën 1'000'000'000 (një miliard) lekë i ndarë në 100'000(njëqind mijë) aksione të zakonshme, të barazvlerëshme me vlerën nominale 10'000(dhjetë mijë) lekë për aksion dhe aksionare të Shoqërisë, Znj. Ridvana Dulaku, që zotëron 34%(tridhjetë e katër përqind) të pjesëve ose 34'000(tridhjetë e katër mijë) aksione nominative , Znj. Holta Dulaku, që zotëron 33%(tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33'000(tridhjetë e tre mijë) aksione nominative dhe Znj. Melina Dulaku që zotëron 33%(tridhjetë e tre përqind) të pjesëve ose 33'000(tridhjetë e tre mijë) aksione nominative, të treja së bashku përbëjnë 100%(njëqindpërqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë "Tring TV" Sh.a.

Ortaket e sipërcituara të Shoqërisë kanë shprehur vullnetin për shitjen e një pjese të aksioneve që zotërojnë në Shoqëri, ndërsa Blerësi ka shprehur interesin për blerjen e një pjese të tyre.

Ortaket e Shoqërisë, nëpërmjet Vendimit të Asamblesë së Ortakëve, kanë vendosur transferimin e aksioneve nëpërmjet shitjes së 80 % të tyre në favor të Blerësit, aksione këto të lira nga çdo detyrim apo barrë ndaj të tretëve.

NENI 1 - OBJEKTI I KONTRATËS

Me anë të kësaj kontrate shitje të aksioneve, me vullnet të lirë dhe të plotë, shitëset Znj. Ridvana Dulaku, Znj. Holta Dulaku, Znj. Melina Dulaku i shesin me rezervë blerësit Z.Sotiraq Toshi, përkatësisht:

Znj. Ridvana Dulaku, shet me rezervë 26.000 (njëzetë e gjashtë mijë) aksione ose 26% të aksioneve që zotëron në shoqëri.

Znj. Holta Dulaku, shet me rezervë 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% të aksioneve që zotëron në shoqëri.

Znj. Melina Dulaku, shet me rezervë 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% të aksioneve që zotëron në shoqëri.

Blerësi Z.Sotiraq Toshi, është plotësisht dakort që të blejë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, ne total 80.000 (tetëdhjetë mijë) aksione ose 80% të aksioneve të shoqërisë TRING TV Sh.a.

NENI 2 - ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Vlera e shitjes së aksioneve në masën 80% (tetëdhjetë përqind) që përsaqësojnë 80.000 (tetëdhjetë mijë) aksione, është në shumën totale prej 200.000.000 (dyqind milion) Lekë, ku pënmimi i shitjes së një aksioni është i barabartë me 2500 Lekë, vlerë për të cilën Palët konsakte deklarojnë se do të likuidohet në formën dhe mënyrën e mëposhtme:

| SHITËSE | BLERËSI | PJESËT NË % E KUOTAVE QË SHITEN | Çmimi i Kuotave të shitura |
|-------------------|---------------|---|--|
| 1. Ridvana Dulaku | Sotiraq Toshi | 26.000 (njëzetë e gjashtë mijë) aksione ose 26% | 65,000,000 (gjashtedhjete e pese milion) Leke |
| 2. Holta Dulaku | Sotiraq Toshi | 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% | 67,500,000 (gjashtedhjete e shtate mijë e peseqind) Leke |
| 3. Melina Dulaku | Sotiraq Toshi | 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) aksione ose 27% | 67,500,000 (gjashtedhjete e shtate mijë e peseqind) Leke |

Palët e mësipërme bien dakort që çmimi filletar i shitjes së aksioneve do t'ë paguhet nëpërmjet transfertës bankare, në llogaritë personale të secilës prej Shitëseve, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, sipas parashikimeve të mëposhtme:

Blerësi do t'ë paguajë vlerën prej 65,000,000 (gjashtedhjete e pese milion) Lekë, që i takon Aksioneres Ridvana Dulaku për shitjen e 26% të aksioneve të zotëruara prej saj, brenda 2 (dy) muajve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate.

Blerësi do t'ë paguajë vlerën prej 67,500,000 (gjashtedhjete e shtate mijë e peseqind) Lekë, që i takon Aksioneres Holta Dulaku për shitjen e 27% të aksioneve të zotëruara prej saj, brenda 4 (katër) muajve nga nënshkrimi i kësaj Kontrate.

Blerësi do të paguajë vlerën prej 67,500,000 (gjashtedhjete e shtate mijë e peseqind) Lekë, që i takon Aksioneres Melina Dulaku për shitjen e 27% të aksioneve të zotëruara prej saj, brenda 6 (gjashtë) muajve nga nënshkrimi i kësaj Kontratë.

Në të ardhmen e shoqërisë secili prej aksionerëve do të vazhdojë të nënshkruajë kapitalin, sipas përqindjes së zotëruar në shoqëri, deri në masën maksimale të tij.

NENI 3 - KALIMI I PRONËSISË DIIE STRUKTURA E RE E SAJ

Shitëset shprehin vullnetin e kalimit të pronësisë mbi aksionet e shitura, objekt i kësaj Kontratë, menjëherë pas nënshkrimit të saj, duke qënë i lirë Blerësi të aplikojë përrregjistrimin e tyre në pronësi të tij në rregjistrin e QKR-së. Në çdo rast, këto aksione në pronësi të Blerësit do të mbeten të blokuara në favor të Shitëseve, deri në shlyerjen e plotë të çmimit të kësaj Kontratë. Vetëm me pagimin tërësisht të vlerës së aksioneve, që do të vërtetohet me paraqitjen dhe depozitim i mandat pagesave bankare përkatëse, mund të hiqet bllokimi mbi aksionet.

Në të tilla rrethana, pas nënshkrimit të kësaj Kontratë dhe rregjistrimit të saj pranë QKR-së, raportet e pronësisë në kapitalin e Shoqërisë "Tring Tv" Shpk për aksionerët e saj do të janë:

1. Z. Sotiraq Toshi, do të zotërojë 80 % (tetëdhjetë përqind) të aksioneve.
2. Znj. Ridvana Dulaku, do të zotërojë 8 % (tetë përqind) të aksioneve.
3. Znj. Holta Dulaku, do të zotërojë 6 % (gjashtë përqind) të aksioneve.
4. Znj. Melina Dulaku, do të zotërojë 6 % (gjashtë përqind) të aksioneve.

NENI 4 - GARANCITE

Shitëset deklarojnë dhe garantojnë se janë titullaret e vetme dhe të ligjshme të aksioneve, që po transferohen nëpërmjet kësaj kontratë dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Shitëset garantojnë Blerësin se me nënshkrimin e kësaj Kontratë, çmimi i shitjes është i vetëm, përfundimtar dhe i pandryshueshëm dhe se prej tyre nuk do të ketë në të ardhmen asnjë pretendim lidhur me të apo me të drejta të lidhura me vetë aksionet.

Mospërbushja e detyrimit të Blerësit për pagimin e çmimit të kësaj Kontratë, në kohën dhe mënyrën e përcaktuar më lart në këtë Kontratë, i jep të drejtën Shitëseve ta konsiderojnë Kontratën të zgjidhur dhe të kërkojnë kthimin e Palëve në gjendjen e mëparshme. Lidhur me këtë, Palët duhet të nënshkruajnë një akt për revokimin e kësaj Kontratë, që do të lejonte kthimin e të drejtave aktuale në favor të Shitëseve, njësoj sikur kjo kontratë të mos ekzistuar kurrë. Mospërpilimi apo mosnënshkrimi i këtij akti nga Blerësi brenda 15 ditëve nga përfundimi i afatit maksimal për kryerjen e pagesave të parashikuara në këtë Kontratë, e

ngarkon atë me detyrimin e pagimit të një kushti penal të barabartë me dyfishin e vlerës së kësaj Kontrate.

NENI 5 - BAZA LIGIORE

Kjo Kontratë Shitje bazohet do të interpretohet e do të zbatohet në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Trgetarët dhe Shoqëritë tregtarë" dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit".

NENI 6 - HYRJA NË FUQI DHE RREGJISTRIMI

Kjo Kontratë hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj duke filluar kësijoj edhe efektet e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë prej saj.

Blerësi ka të drejtë të paraqesë për rregjistrim në QKR këtë Kontratë, menjëherë pas nënshkrimit të saj, me qëllim njohjen dhe respektimin e saj edhe prej të tretëve.

NENI 7 - DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo kontratë u hartua në 7 (shtatë) ekzemplare me vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe, nga një kopje të së cilës e marrin Palët, një kopje depozitohet në QKR për të bërc rregjistimet e pasqyrimet e nevojshme, një kopje depozitohet në dokumentacionin e Shoqërisë dhe një kopje mbetet në arkivën e zyrës së Noterisë.

Kontrata u kuptua prej palëve, të cilat deklaruan se janë dakort me sa më sipër, dhe e nënshkruan rregullisht përpala meje dhe unë noterja, e vërtetoj atë sipas ligjit.

SHITËSET

Ridvana DULAKU

Holta DULAKU

Melina DULAKU

NOTERE
Mariana DAKA

BLERËSI

Sotiraq TOSHI





EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | | |
|---|---|--------------|-------------------|
| 1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) | K61931005K | | |
| 2. Data e Regjistrimit | 31/07/2006 | | |
| 3. Emri i Subjektit | Tring TV | | |
| 4. Forma ligjore | Shoqëri Aksionare | | |
| 5. Data e themelimit | 14/12/2004 | | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 14/12/2004 Deri: | | |
| 7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga "Fabrika e Qelqit", zona kadastrale 8230, Pasuria Nr.2/63, Godina Qendrore, Njesia Bashkiake nr.6 | | |
| 8. Kapitali | 250.000.000,00 | | |
| 9. Vlera e kapitalit të shlyer: | 250000000.0000 | | |
| 10. Numri i aksioneve: | 100.000,00 | | |
| 10.1 Vlera nominale: | 2.500,00 | | |
| 11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë | té zakonshme | me përparësi | me të drejtë vote |
| 11.1 Numri për secilën kategori | | | pa të drejtë vote |
| 12. Objekti i aktivitetit: | Ndertimin dhe tregtimin e sistemeve te telekomunikacionit dhe transmetimeve televizive te gdo lloji (tokesor, me kabllo ose satelit, ne forme te koduar apo te pakoduar) me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuara per publikun nepermjet vave elektromagnetike, kabllove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjeter.Tregtimin e aparaturave per sistemet e transmetimit dhe marrjes se vave televizive.Ndertimin dhe shfrytezimin e rrjeteve numerike, per transmentimin analog tokesor ose satelitor te platformave me destinacion per ofrimin e sherbimit te transmetimit | | |



per publikun. Prodhimin, transmetimin, ritransmetimin dhe shitjen ne menyre dixhitale te produkteve dhe sherbimeve audio e video. Ushtrimin e veprimtarise radio-televizive, e cila konsiston ne krijimin e nje rrjeti radio-televiziv me shtrirje ne shkalle kombetare si nepermjet mbulimit direkt te territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe nepermjet mbeshtetjes ne median rajonale me shperndarje nepermjet valeve si dhe via kavo. Prodhimin, tregtimin dhe shperndarjen e programeve te ndryshme radio-televizive si dhe i video-audio kasetave ne formate te ndryshme, profesionale ose jo, bashkepunimin me rrjete televizive vendase dhe te huaja dhe perfaqesimin reciprok te tyre si dhe aktiviteve te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe cdo aktivitet tjeter te nevojshem ose te dobishem per ushtrimin e veprimtarise radio-televizive. Organizimin e aktiviteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audiovizuale te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Organizimin e spektakleve, shfaqjeve teatrale, sfilatare te modes, botimeve te ndryshme, produksioneve, video dhe audio, perzgjedhjeve te vidioklipave te ndryshme nepermjet konkurseve, perzgjedhjeve te modeleve mbarekombetare, shqipfolese. Pjesemarrjen ne aktivitete nderkombetare, qe lidhen me fushen e modes, modeleve e misseve, qe shpallen vetem nga aktiviteti i kesaj shoqerie, me qellim promovimin e vlerave te ndryshme te bukurise, kultures e historise shqiptare jashte vendit, duke u prezantuar ne keto te fundit, siç njihet vendi yne ne te tilla prezantime mbi bazen e leksikologjise boterore. Prodhimin dhe shitjen e spektakleve televizive, shfaqjeve teatrale, shfaqjeve, dokumentareve televiziv, reklamave si dhe shperndarjen e tyre ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Prodhimin dhe shperndarjen e filmave artistike te metrazhit te shkurter, te mesem dhe te gjate, te filmave vizatimore, filmave publicitare dhe te programeve audio-vizuale te cdo lloji, qe prodhohen ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj; Dublimin dhe subtitrimin e filmave te huaj dhe te filmave shqiptare per vende te tjera. Prodhimin dhe tregtimin e botimeve te ndryshme, fletepalosjeve, shtypshkrimeve, qe i pershtaten ketij objekti, agjensive turistike, hotelerive, moteleve, fshatrave turistike, si dhe agjensive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, agjensive komisionere, etj. Zhvillimin dhe ndermjetesimin e projekteve per aktivite te ndryshme te shoqerive me aktivitet artistik, muzikor, teatral, kinematografik dhe audiovizual te cdo lloji ne Shqiperi dhe jashte kufijve te saj. Sigurimin e projekteve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale dhe nenshkrimin e kontratare afatgjata per realizimin e ketyre projekteve. Ndermjetesimin, nxjerrjen dhe perpunimin e materialeve artistike, muzikore, teatrale, kinematografike dhe audio-vizuale te te gjitha llojeve, veprimtari, sherbime, etj. Kontaktimin me persona fizike dhe juridike, vendas ose te huaj, per gjetjen e tregjeve te blerjes dhe shitjes per prodhimet artistike te te gjitha llojeve, te shoqerise dhe shoqerive te tjera.

| | | |
|--|---|-------------------|
| 13. Sistemi i administrimit | <input type="checkbox"/> me një nivel <input checked="" type="checkbox"/> me dy nivele | |
| 14. Administratori/ët | Ridvana Dulaku | |
| 14.1 Afati i emëritit | Nga : 16/03/2012 | Deri : 15/03/2018 |
| 15. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka). | <p>Të kryejë me të drejtë nënshkrimi nga ana e njërit prej Administratorëve individualisht, kryetarit Ridvana Dulaku ose anëtarit Artan Dulaku, të çdo operacioni financiar dhe/ose tregtar (kontrata, operacione, cedimi, kredie, transferta bankare, likujdime etj) aktive dhe pasive që kanë lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqerisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përm bushje të formalitetave të nevojshme, duke përfshirë dorëzaninë, për shuma pa limit, për çdo operacion financiar por gjithnjë në kufijtë e parashikuar nga ligji. Kryetarja e Këshillit të Administrimit, Ridvana Dulaku, do të përfaqësojë shoqërinë dhe do të ushtrojnë të gjitha kompetencat e shoqërise, me të drejta dhe detyrimet e parashikuara nga nen 19, i statutit te Shoqerisë.</p> | |
| 16. Administratori/ët | Artan Dulaku | |
| 16.1 Afati i emëritit | Nga : 16/03/2012 | Deri : 15/03/2018 |
| 17. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. 17.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka). | <p>Të kryejë me të drejtë nënshkrimi nga ana e njërit prej Administratorëve individualisht, kryetarit Ridvana Dulaku ose anëtarit Artan Dulaku, të çdo operacioni financiar dhe/ose tregtar (kontrata, operacione, cedimi, kredie, transferta bankare, likujdime etj) aktive dhe pasive që kanë lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqerisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përm bushje të formalitetave të nevojshme, duke përfshirë dorëzaninë, për shuma pa limit, për çdo operacion financiar por gjithnjë në kufijtë e parashikuar nga ligji.</p> | |
| 18. Administratori/ët | Sotiraq Toshi | |
| 18.1 Afati i emëritit | Nga : 16/03/2012 | Deri : 15/03/2018 |
| 19. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. 19.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka). | <p>Anetari i Keshillit te Administrimit Z.Sotiraq Toshi, do te perfafesoje shoqerine dhe do te ushtroje te gjitha kompetencat e shoqërise, vetem per marredheniet e punesimit te shoqerise me punemarresit e saj. Administratori Ligjor i</p> | |



| | |
|--|---|
| | <p>shoqerise nuk mund te nenshkruaje dhe te ndermarre asnje lloj veprimi ose operacioni tjeter, financiar ose tregtar, ne emer dhe per llogari te shoqerise, perveç kontratave te punes me punonjesit sipas draftit tip te miratuar nga keshilli i administritimit dhe organogrames se miratur me Vendim te Keshillit Mbikeqyres se Shoqerise . Administratori Ligjor i shoqerise nuk ka te drejte te nenshkruajeasnje lloj kontrate, akti ligjor, kontrate, marreveshjeje, deklarate te çdo lloji qe do te kete lidhje me/dhe asetet e shoqerise. Per çdo lloj akti ligjor, qe do te kete lidhje jashte detyrave te ngarkuara, administratori ligjor i shoqerise do te veproje vetem ne baze te nje Vendimi te Keshillit Mbikeqyres se Shoqerise. Nuk ka te drejte per te hyre ne transaksione, te nenshkruajeasnje lloj akti ligjor apo per te ekzekutuar ndonje akt, qe perfshin pasuri te luajtshme apo te paluajtshme te Shoqerise, pavaresisht nga vlera e transaksionit apo e aktit. Administratori Ligjor i shoqerise nuk ka te drejte te kryejeasnje nga detyrat e parashikuara nga dispozitat e nenit 19, te statutit te shoqerise, perveç atyre qe lidhen me marredheniet e punes.</p> |
| 20. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(<i>plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele</i>) | Holta Dulaku |
| 20.1 Kryetar/anëtar | Anetar |
| 20.2 Afati i emërimit | Nga : 16/03/2012 Deri : 15/03/2018 |
| 21. Anëtar i Pavarur | Po |
| 21.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo |
| 21.2 Kushtet e pjesëmarrjes | |
| 22. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | |
| 23. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(<i>plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele</i>) | Adrian Dulaku |
| 23.1 Kryetar/anëtar | Anetar |
| 23.2 Afati i emërimit | Nga : 16/03/2012 Deri : 15/03/2018 |
| 24. Anëtar i Pavarur | Po |
| 24.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo |
| 24.2 Kushtet e pjesëmarrjes | |
| 25. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | |
| 26. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës(<i>plotësohet nëse është Sh.a me dy nivele</i>) | Genci Dulaku |
| 26.1 Kryetar/anëtar | Anetar |
| | Nga : 16/03/2012 Deri : 15/03/2018 |



| | | |
|--|---|-------------------|
| 26.2 Afati i emërimit | | |
| 27. Afetar i Pavarur | Po | |
| 27.1 Përfaqesues i Punëmarrësve | Jo | |
| 27.2 Kushtet e pjesëmarrjes | | |
| 28. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore. | | |
| 29. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar | Esmeralda Balluku | |
| 29.1 Afati i emërimit | Nga : 16/03/2012 | Deri : 15/03/2015 |
| 30. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar | Tatjana Filto | |
| 30.1 Afati i emërimit | Nga : 16/03/2012 | Deri : 15/03/2015 |
| 31. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar | "FILTO AUDITING" | |
| 31.1 Afati i emërimit | Nga : 16/03/2015 | Deri : 15/03/2018 |
| 32. Aksionarët | Holta Dulaku | |
| 32.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote : 6000.0000 Pa te drejte vote : | |
| 32.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 6,00 | |
| 33. Aksionarët | Melina Dulaku | |
| 33.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote : 6000.0000 Pa te drejte vote : | |
| 33.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 6,00 | |
| 34. Aksionarët | Sotiraq Toshi | |
| 34.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote : 80000.0000 Pa te drejte vote : | |
| 34.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 80,00 | |
| 35. Aksionarët | Ridvana Dulaku | |
| 35.1 Numri i Aksioneve | Me te drejte vote : 8000.0000 Pa te drejte vote : | |
| 35.2 Përqindja e pjesëmarrjes | 8,00 | |
| 36. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Rrua "Don Bosko", kompleksi "Don Bosko", kulla 7, kat 2. Tirane Tirane TIRANE Automjet tip Ford Transit, me targe TR 2842 R. Tirane Tirane TIRANE Rrugë Don Bosko, Kompleksi Don | |

| | |
|---|---|
| | Bosko, Kulla 7, Kati Perdhe, Nr.7 Tirane Tirane TIRANE Rruga Don Bosko, Kompleksi Don Bosko, Kulla 7, Kati Perdhe, Nr.5 Tirane Tirane TIRANE Automjet tip Ford Transit, me targe TR 2840 R. Tirane Tirane TIRANE Automjet me targe TR 8054 S. Tirane Tirane TIRANE Rruga Don Bosko, Kompleksi Don Bosko, Kulla 7, Kati Perdhe, Nr.6 |
| 37. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: Tring TV E-Mail: info@tring.tv Telefon: 04802000 044800008 |
| 38. Statusi: | Aktiv |

Lista e Dokumenteve:

Akti i ekspertimit te ekspertit vleresues te licensuar per pagesen e kapitalit ne natyre

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Dokumenti i autorizimit

Vendim i asamblese se per gjithshme

Regjistrimi Fillestar:

Datë : 14/02/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)